



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 11.9.2018

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR

PROJEKTLIGJIN “RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (MARRËSI), PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE DHE EKONOMISË, DHE KfW FRANKFURT AM MAIN (KfW), PËR PROGRAMIN E REHABILITIMIT TË KONVIKTEVE TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS SIPAS PARIMIT TË EFIÇENCËS SË ENERGJISË, FAZA II”

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi projektligjin “Ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (marrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin e rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas parimit të efijencës së energjisë, faza II”, në mbledhjen e datës 10 dhe 11 shtator 2018.

Të pranishëm në mbledhje ishin përfaqësues të Ministrisë së Energjisë dhe Infrastrukturës, si dhe përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Projektligji synon financimin me një fond grant prej rreth 2 milionë eurosh të programit rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas parimit të efijencës së energjisë. Kjo është faza e dytë e financimit, pas asaj që ka nisur me financimin prej 4.5 milionë eurosh nga KfW-ja të miratuar në vitin 2016.

Qëllimi i programit i cili ka një kosto prej 7.8 milionë eurosh, është rehabilitimi i konvikteve të Universitetit të Tiranës, në funksion të rritjes e efijencës së energjisë dhe kushtet e komfortit të studentëve sipas kërkesave minimale të performancës së energjisë. Konkretisht, nga 29 ndërtesa të Qytetit Studenti, me këto fonde do të rikonstruktohen plotësisht 5 prej tyre.

Komponentë të këtij rikonstruksioni janë termoizolimi e hidroizolimi i taracave, si dhe vendosja e paneleve diellore në to; zëvendësimi i dyerve e dritareve me qëllim ruajtjen e energjisë e reduktimin e kërkesës për energji; si dhe instalimet e reja elektrike e hidraulike për përmirësimin e jetesës së studenteve sipas standardeve europiane.

Financimi shtesë që akordohet me anë të këtij granti vjen si rezultat i bisedimeve qeveritare mbi bashkëpunimin për zhvillim të mbajtur po në vitin 2016, ndërmjet qeverisë shqiptare dhe asaj gjermane, ku u dakordësua shtimi i shumës së financimit për ta bërë investimin më të plotë.

Auditimi energjetik i ndërtesave, identifikimi i nevojave të rinovimit të tyre, identifikimi i masave të ndryshme të efijencës së energjisë që mund të aplikohen, reduktimi i konsumit të përgjithshëm të

energjisë së ndërtesave, si dhe llogaritja e reduktimit të karbonit si rezultat i këtyre masave, janë objektivat kryesore të këtij programi.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare. Deputetët e opozitës nuk ishin të pranishëm në mbledhje.

Rakip SULI

Relator

Eduard SHALSI

Kryetar